



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT ELBASAN

Nr 634 prot

Elbasan më 06 /10 /2025

VENDIM

Nr 39 , datë 06 .10 .2025

Për një ndryshim në VKQ Nr.35, datë 23.12.2024, “Për bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta me bashkitë për vitin 2025”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozim të Grupit të menaxhimit Strategjik, Vendimit të Këshillit të Qarkut Elbasan Nr.33, datë 23.12.2024 “Për miratimin e planit të buxhetit të vitit 2025 për Këshillin e Qarkut Elbasan”, si dhe shkresës së Bashkisë Elbasan me Nr.4781 Prot, datë 23.09.2025 “Kërkesë për ndryshim në prioritetet e financimit-rialokim fondesh për investimin në sallën e shkollës “Onufri”, me propozim të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Elbasan, Këshilli i Qarkut Elbasan në mbledhjen e datës: 06 .10 .2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në VKQ, Nr.35, datë 23.12.2024 “Për bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta me bashkitë për vitin 2025”, Bashkëfinancim-Bashkia Elbasan, “Arredimi Ambjental dhe Sistemet Audio të Sallës së Koncerteve në Shkollën “Onufri” për vitin 2025, përsa i përket fondit, ku Këshilli i Qarkut Elbasan do të financojë shumën **11 123 840** lekë.
- 2.Projekti i mësipërm do të zbatohet nga Bashkia Elbasan.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.
- 4.Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike dhe Drejtoria e Financës, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Marrëdhënieve me Jashtë për zbatimin e këtij vendimi.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ermira CRUPI